



ERVJOLA OSMANAJ

MSC

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

MSC. Ervjola Osmanaj është Asistente Lektore në Dep. i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim dhe Kordinatore e Institutit AIPA

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

Shkenca Politike dhe Teori Politike

EMAIL

e.osmanaj@edu.umb.al

BIO

Ervjola Osmanaj ka lindur në Bajram Curri, me 25 Gusht 1990. Ajo ka përfunduar studimet e larta Bachelor në Shkenca Politike (2009-2012) dhe më pas ka kryer një Master Shkencor në Teori Politike (2012 -2014) pranë Universitetit European të Tiranës.

Që nga viti 2015 ajo është e angazhuar në mënyrë aktive në sektorin e shoqërisë civile, duke punuar dhe ndërtuar profilin e saj publik në mbrojtje të të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Në vitin 2016 ajo i'u bashkua stafit të CRCA/ECPAT Shqipëri, fillimisht si Koordinator Programi dhe më pas si Menaxhere Programi në disa programe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse. Ervjola ka punuar dhe si Menaxhere pranë Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë - ALO116111 si dhe ka koordinuar Fushatën Kombëtare të ALO116111, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe UNICEF. Gjithashtu, ajo ka mbajtur dhe pozicionin e Media Person pranë Koalicionit për Arsimin në Shqipëri - ACE. Përgjatë vitit 2016-2021, Ervjola ka mbajtur dhe postin e Sekretares së Përgjithshme të Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN) dhe më pas atë të Presidentes.

Në të njejtën kohë ajo është autore dhe bashkë-autore e një sërë studimesh dhe raportesh lidhur me të drejtat e të rinjve në Shqipëri, etj.